

Denet
Nr. _____ Prot

Nr. _____ Prot

KONTRATË SHËRBIMI PËR AKSES INTERNETI

Lidhur sot më / / ndërmjet:

Denet person Juridik, i regjistruar me Vendim Nr _____ datë _____, me administrator Denis Dedej, me adresë Tirane Synej SYNEJ Synej, Lagjja Çaçave, objekt 1 katesh, zona kadastrale nr 3554, nr pasuri 123/7, që më poshtë do të quhet **“Ofrues Shërbimi”**

Dhe

_____, që më poshtë do të quhet **“Klient”**

Të dy sëbashku referuar si **“Palët”** dhe individualisht si **“Pala”**.

1. OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është: Ofrimi i shërbimit të Aksesit në Internet nga Ofruesi i Shërbimit për nevoja të Klientit me specifikimet e mëposhtme si dhe me përcaktimet dhe kushtet e kësaj kontrate dhe Aneksit 1 dhe të Aneksit 2 (përshirë Aneksin 2.1 Procesverbali i Dorezimit të Pajisjeve, Procesverbali i Pranimit të Ofrimit të Shërbimit dhe Procesverbali i Terheqjes së Pajisjeve) pjesë perberese dhe të pandashme të kontrates.

2. KOHËZGJATJA

Kontrata hyn në fuqi më nënshkrimin e saj nga Palët dhe do të jetë në fuqi për një periudhë **3 muajore** nga data e nënshkrimit të saj nga Palët (**“Afati fillestar”**).

Kjo Kontratë do të rinovohet me të njëjtat kushte dhe terma nëse asnjëra nga Palët nuk njofton me shkrim palën tjetër 30 (tridhjetë) ditë para përfundimit të Afatit për përfundim të saj.

3. INSTALIMI, TESTIMI, MIRËFUNKSIONIMI DHE DOREZIMI I PAJISJEVE

Ofruesi i Shërbimit merr përsipër aktivizimin e shërbimit brenda 15 ditëve nga data e nënshkrimit të Kontratës.

Palët bien dakort që gjatë afatit të përmendur në pikën 3.1 të këtij Neni, të konfirmojnë aktivizimin e shërbimit, mirëfunktionimin e tij si dhe marrjen e dorezimit të pajisjeve, me anë të të nënshkrimit të Procesverbalit të Dorezimit të Pajisjeve dhe Procesverbalit të Pranimit të Ofrimit të Shërbimit, procesverbale të cilat në cdo rast do të jenë sipas formatit të përcaktuar në Aneksit 2.1, të nënshkruar rregullisht nga personat e autorizuar të palëve.

Në rast se Klienti nuk ka ankesë për Procesverbalin e Dorezimit të Pajisjeve dhe Procesverbalin e Pranimit të Ofrimit të Shërbimit, brenda 5 ditëve nga dërgimi i tij nga Ofruesi i shërbimit, dhe gjatë kësaj periudhe nuk ka paraqitur kundërshtime të vlefshme mbi mirëfunktionimin e shërbimit dhe pajisjeve, atëherë shërbimi do të konsiderohet si i aktivizuar dhe i pranuar nga Klienti me të gjithë Pajisjet perkatëse.

Palët bien dakort që brenda 5 ditëve nga data e nënshkrimit të procesverbaleve të përmendura në pikën 3.2 të kontrates, shërbimi të aktivizohet dhe palët të kryejnë të gjithë testet e nevojshme pa pagesë të mirëfunktionimit të shërbimit. Me përfundimin e afatit 5 ditor të testimeve nga data e nënshkrimit të procesverbaleve të përmendura në pikën 3.2, Ofruesi i Shërbimit do të emetojë faturat perkatëse tatimore sipas kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë.

Pajisjet sëbashku me aksesoret e përdorura për ofrimin e shërbimit objekt të kësaj kontrate, janë në cdo rast prone e Ofruesit të Shërbimit dhe i jepen në përdorim Klientit. Dorezimi i pajisjeve sëbashku me aksesoret nga Ofruesi i Shërbimit tek Klienti kryhet nepermjet nënshkrimit të procesverbaleve të cilat në cdo rast duhet të jenë sipas përcaktimeve të Aneksit 2.1 në mënyrë që të jenë të vlefshme (ketu e në vijim referuar si « Pajisja/jet ». Pas nënshkrimit nga personat e autorizuar të procesverbaleve, të cilat në cdo rast është në përputhje me formatin e përcaktuar në Aneksin 2.1, do të bashkelidhet kësaj kontrate si pjesë perberese dhe e pandashme e saj.

Në rast përfundimi/nderprerje të kontrates, të gjitha Pajisjet sëbashku me aksesoret të vena në dispozicion të Klientit duhet t'i rikthehen Ofruesit të Shërbimit nepermjet nënshkrimit të Procesverbalit të Terheqjes së Pajisjeve në kushte të njëjta sikurse Denet e ka dorezuar tek Klienti përveç amortizimit të pajisjes nga përdorimi i zakonshëm, ose në rast të kundërt Klienti duhet të paguajë vlerën e pajisjeve sëbashku me aksesoret sikurse do të përcaktohet në Procesverbalin e Dorezimit të Pajisjeve, procesverbal i cili në cdo rast duhet të jetë në përputhje me formatin e përcaktuar në Aneksin 2.1.

Detyrimi për pagim të vlerës së pajisjes sëbashku me aksesoret sikurse do të parashikohet në Procesverbalin e Dorezimit të Pajisjeve e cila në cdo rast duhet të jetë në përputhje me formatin e përcaktuar në Aneksin 2.1, aplikohet edhe për rastet kur pajisja/pajisjet sëbashku me aksesoret e dhënë në përdorim, humbet/asin dhe/ose demtohet/hen nga Klienti dhe/ose Klienti nuk nënshkruan procesverbalet perkatëse sipas formatit dhe sipas parashikimeve të bera në këtë kontratë.

- 3.7 CmONTIMI I pajisjeve sëbashku me aksesoret do të kryhet nga Denet, brenda një afati 15 ditor nga përfundimi/nderprerja e kontrates. Në cdo rast, Klienti është përgjegjës për ruajtjen dhe mosdëmtimin e pajisjeve sëbashku me aksesoret deri në datën e rikthimit/dorezimit të tyre tek Ofruesi i Shërbimit nepermjet nënshkrimit të Procesverbalit të Terheqjes së Pajisjeve e cila në cdo rast do të jetë sipas formatit të përcaktuar në Aneksin 2.1.

4.

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

Të drejtat dhe detyrat e Klientit

Klienti merr në përdorim shërbimin e Aksesit të Internetit të ofruar nga Ofruesi i Shërbimit dhe detyrohet që ta përdorë atë vetëm për nevojat e veta.

Klienti mund të kërkojë në çdo kohë gjatë periudhës në fuqi të kësaj kontrate ndryshime të karakterit teknik për të cilat palët bien dakort që të ofrohen dhe në përputhje me mundësitë teknike të Denet. Për këto ndryshime palët do të nënshkruajnë një Aneks kontrate.

Në rast rinovimi në vijim të kontratës, Klienti nuk i nënshtrohet pagesës së instalimit apo testit të parashikuar në kontratë.

Klienti mund të kontaktojë me Ofruesin e Shërbimit nëpërmjet numrit telefonik të kujdesit ndaj klientit apo pikat e kontaktit të përcaktuara në Formularin Teknik.

Klienti merr përsipër të kryejë pagesat përkatëse ndaj Ofruesit të shërbimit, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj kontrate për objektin e kësaj Kontrate të përcaktuar në Aneksin 1, pavarësisht nëse Klienti e përdor ose jo shërbimin.

Klienti është i detyruar që Aksesin në Internet të marrë nga Ofruesi i Shërbimit të mos e përdorë për të sulmuar dhe dëmtuar burime dhe informacione të ndryshme të internetit, për të dërguar spam email- eve, për të modifikuar dhe ndërhyrë në informacionet që kalojnë në këtë lidhje, për të shpërndarë dhe publikuar e- informacione të paligjshme, për të kryer dëmtime të ndryshme në hardware dhe software ndaj palëve të treta.

Klienti bie dakort që gjatë afatit të përmendur në pikën 3.1 të këtij Neni, të konfirmojë aktivizimin e shërbimit, mirëfunksionimin e tij si dhe marrjen në dorezim të pajisjeve, me anë të të nënshkrimit të Procesverbalit të Dorezimit të Pajisjeve dhe Procesverbalit të Pranimit të Ofrimit të Shërbimit, procesverbale të cilat në cdo rast do të jenë sipas formatit të përcaktuar në Aneksin 2.1, të nënshkruar rregullisht nga personat e autorizuar të palëve si dhe merr përsipër të gjithë përgjegjësitë e parashikuara në Nenin 3 të kësaj kontrate.

Klienti është përgjegjës për ruajtjen dhe mosdëmtimin e pajisjeve sebashku me aksesoret deri në datën e rikthimit/dorezimit të tyre tek Ofruesi i Shërbimit nëpërmjet nënshkrimit të Procesverbalit të Terheqjes së Pajisjeve e cila në cdo rast do të jetë sipas formatit të përcaktuar në Aneksin 2.1. Në të kundërt Klienti duhet të paguajë vlerën e pajisjeve sebashku me aksesoret sikurse do të percaktohet në Procesverbalin e Dorezimit të Pajisjeve formati i të cilit është pjesë e Aneksit 2.1.

Të drejtat dhe detyrimet e Ofruesit të Shërbimit

Mirëmban pajisjet dhe aparatat që ofrojnë Aksesin Internet, brenda standarteve dhe normativave teknike të Denet.

Ofruesi i Shërbimit do të mundësojë Aksesin në Internet për Klientin me cilësinë sipas normave e standarteve ndërkombetare si dhe të sigurojë shpejtësinë e parashikuar në nenin 1 të kësaj kontrate. Denet do të ofrojë shërbim vetëm për ato pika të rëna dakort mes palëve me marreveshja me shkrim si dhe në bazë të aftësive, mundësive dhe kapaciteteve teknike të Denet dhe Klienti nuk do të ketë asnjë pretendim ndaj Denet në lidhje me këtë.

Operatori ka të drejtë të kryejë kontroll për përdorimin e lidhjes.

Ofruesi i Shërbimit ka të drejtë që në çdo moment të zgjidhë kontratën menjëherë në të gjitha rastet kur Klienti nuk përmbushë e plotëson kërkesat e pikës 4.1 të Kontratës.

Ofruesi i Shërbimit siguron vijimin e Aksesit Internet për Klientin nga nyja e tij në Rajonet Denet Synej deri tek nyja e Klientit sipas skemës së paraqitur në Aneksin 2 dhe sipas procesverbaleve që do të nënshkruhen mes paleve të cilat në cdo rast do të jenë sipas formatit të përcaktuar në Aneksin 2.1.

Ofruesi i Shërbimit jep në përdorim Klientit 1 (një) ditë testim pa pagesë nga data e nënshkrimit të procesverbaleve të përmendura në pikën 3.2 të kontratës, për akses interneti, sipas shpejtësisë së transmetimit të shprehur në procesverbalet që do të nënshkruhen mes paleve, të cilat në cdo rast do të jenë sipas formatit të përcaktuar në Aneksin 2.1.

Merr përsipër riparimin e defekteve brenda standarteve dhe mundësive teknike ekzistuese sipas Aneksit 3 "Marreveshja e Nivelit të Shërbimit", bashkëlidhur Kontratës, dhe nuk mban përgjegjësi për dëmtimet nga të tretët që sjellin mosfunksionimin e shërbimit, pavarësisht kohëzgjatjes.

Për qëllime mirëmbajtjeje, Ofruesi i Shërbimit ka të drejtë të ndërpresë Aksesin në internet në mënyrë të njëanshme. Në këtë rast Ofruesi i Shërbimit është i detyruar të njoftojë Klientin të paktën 24 orë para ndërprerjes dhe kohëzgjatja e ndërprerjes do të jetë, jo më shumë se 24 orë.

Ofruesi i Shërbimit duhet t'i ofrojë pa pagesë Përdoruesit suport teknik për 24 orë të njëpasnjëshme, për shtatë ditë të javës. Për çdo problem fillimisht duhet të dërgohet një e-mail tek adresa intdenet@gmail.com

Cdo dokument, njoftim apo komunikim mes paleve kontraktuese do të dërgohet me poste ose do të dorezohet personalisht në adresat e tyre me poshte si dhe tek personat e autorizuar si me poshte:

Denet

Kontakt: Denis Dedej

Celular: 00355672620391

E-mail: intdenet@gmail.com

Nga Grupi Teknikes se Denet:

Kontakt: Denis Dedej

Celular: 00355672620391

E-mail: intdenet@gmail.com

Për Klientin:

Kontakt: _____

Celular: + 355 _____

Fiks: +355 _____

E-mail: _____

Nga Grupi Teknikes se Klientit:

Kontakt: _____

Celular: _____

Fiks: _____

E-mail: _____

Klienti deklaron se personat e kontaktit/te autorizuar prej tij sikurse jane cituar me siper (dokumentat e identifikimit te te cileve jane bashkelidhur kesaj marrëveshje), jane personat e autorizuar qe te nënshkruajnë ne emër dhe për llogari te tij, te gjithë dokumentacionin, procesverbalet dhe/ose formularët e tjerë te nevojshëm ne lidhje me këtë kontrate per sherbimin objekt te kesaj kontrate. Klienti duhet te njoftojnë menjëherë me shkrim Ofruesin e Sherbimit ne rast ndryshimi adrese/personi te autorizuar te pikës se kontaktit te percaktuar ne kete Nen.

5. PËRFUNDIMI I KONTRATËS

Palët mund të zgjidhin këtë kontratë përpara afatit të përcaktuar, me nje njoftim me shkrim 60 ditë përpara përfundimit. Ofruesi i Shërbimit ka të drejtë të përfundojë në çdo kohë këtë kontratë, duke njoftuar Klientin 30 ditë përpara përfundimit. Tarifat e përcaktuara në Aneksin 1 të kësaj Kontrate mbeten të pandryshuara deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së kësaj kontrate. Palët detyrohen që çdo komunikim midis tyre të realizohet me shkrim në adresat e përcaktuara në pikën 4.2.10 të kësaj kontrate. Çdo kërkesë e Klientit për ndryshim të kushteve të kontratës do ti paraqitet Ofruesit të Shërbimit me shkrim 30 ditë përpara dhe do të jetë objekt i ndryshimeve të Aneksive të kësaj kontrate. Deri në nënshkrimin e amendamentit përkatës, palët do të vazhdojnë të zbatojnë termat dhe përcaktimet e kontratës bazë.

6. PAGESAT

Tarifa e instalimit e cila aplikohet për çdo pikë të lidhur, dhe ajo mujore për shërbimin, objekt i kësaj kontrate, dhe specifikimet përkatëse jepen në Aneksin Nr.1 të kësaj kontrate. Klienti i paguan Ofruesit të Shërbimit tarifën e paraqitura në Aneksin Nr. 1 bashkangjitur si pjesë përbërëse e kësaj kontrate të cilat mbeten të pandryshuara deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së kësaj kontrate. Pagesës mujore i shtohet TVSH-ja në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Pagesat do të kryhen me parapagim në njesinë e shërbimit Denet dhe bankare që përcaktohet më poshtë në nenin 11 Adresat. Ofruesi i Shërbimit emeton faturën tatimore brenda datës 5 të çdo muaji, për shërbimin që do të ofrohet në muajin pasardhës. Klienti duhet të paguajë vlerën e instalimit të shërbimit, jo më vonë se 5 ditë nga aktivizimi i shërbimit. Se bashku me këtë vlerë Klienti do të faturohet për muajin në të cilin ka filluar shërbimi në proporcion me ditët që e merr këtë shërbim si dhe për shërbimin që do ti ofrohet në muajin pasardhës.

7. PENALITETET

Për mosrespektim të afatit të pagesës sipas pikës 6.4, Klientit do t'i pezullojë me datë 1 të muajit ofrimin e shërbimit dhe Klienti nuk do të ketë asnjë pretendim në lidhje me këtë. Ofruesi i Shërbimit do të zgjidhë kontratën në mënyrë të njëaneshme, nëse Klienti 30 ditë pas përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 6.4/6.6 nuk ka realizuar pagesën e detyrimit respektiv. Në rast konstatimi se Klienti kryen aktivitet jashtë kushteve të kontratës dhe/ose parametrave teknike të kësaj kontrate si dhe në kundërshtim me aktivitetin e Ofruesit të Shërbimit, ky i fundit ka të drejtë të ndërpresë shërbimet në mënyrë të menjëherëshme pa asnjë përgjegjësi ndaj Klientit. Nëse Klienti vendos të zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme përpara afatit fillestar të përcaktuar në Kontratë, Ofruesi i Shërbimit ka të drejtë të aplikojë një Penalitet në masën 100% të detyrimit që do të duhej ti paguante Ofruesit të Shërbimit nëse shërbimi do të zgjasë deri në fund të afatit të përcaktuar në kontratë.

8. INFORMACIONI KONFIDENCIAL

Klienti duhet të ruajë në konfidencë të gjithë dokumentacionin dhe të dhënat e tjera që lidhen me këtë kontratë dhe do të mbajë përgjegjësi dhe do të dëmshpërblejë Ofruesin e Shërbimit për çdo shkelje apo mosrespektim të konfidencialitetit. Kjo kontratë dhe përmbajtja e saj nuk do t'ju bëhet e ditur paleve të treta me përjashtim të rasteve kur kjo kërkohet nga ligji.

9. FORCAT MADHORE

Asnjëra nga palët nuk mban përgjegjësi për mosekzekutimin e plotë apo të pjesëshëm të detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë kur kjo gjë ka ardhur si pasojë e forcave madhore ashtu sic parashikon ligji. Në këtë rast palët me mirëkuptim dhe miratim të përbashkët mund të caktojnë një afat tjetër të arsyeshëm për ekzekutimin e mëtejshëm të detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë.

10. LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Kjo kontratë është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate midis palëve, do të zgjidhen me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjelltë midis tyre, në rast të kundërt palët kanë të drejtë ti drejtohen për zgjidhje të konfliktit Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo Kontratë hartohet në 2 kopje në gjuhën shqipe, nga një kopje per secilën palë.

11. ADRESAT JURIDIKE

| Denet | Klienti |
|--|----------------|
| Tirane Synej SYNEJ Synej,Lagjja Çaçave,objekt 1 katesh ,zona kadastrale nr 3554,nr pasuri 123/7 NIPTI M12711801L Adresa Bankare | |

Denet

Denis Dedej
Administratore

Klient

[Firme]

[Firme]

ANEKS 1
I KONTRATËS PËR DHËNIE AKSES INTERNETI

| Nr | Adresa | Kapaciteti (Mbps) | Tarifa Mujore (lek) pa TVSH |
|-----------|---------------|--------------------------|------------------------------------|
| 1 | Synej | -/- | 0 |

***Shënim:** Të gjitha tarifat e mësipërme janë LEK pa TVSH.*

Denet

Emër Mbiemër Firmë

Klient

Emër Mbiemër Firmë

ANEKSI 2
SHËRBIMI “AKSES I DEDIKUAR”
ZGJIDHJA TEKNIKE PËR SHËRBIMIN “AKSES I DEDIKUAR INTERNETI”